

Titulli i lëndës: Bazat e Komunikimit

Informata themelore për lëndën	
Fakulteti:	Fakulteti i Studimeve Islame
Titulli i lëndës:	Bazat e komunikimit
Drejtimi:	Teologji Islame
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve	Viti i IV-të semestri i dytë
Numri i orëve në javë	2+1
Kreditë ECTS:	4 ECTS:
Koha/Vendi	Klasa 1/ sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Asist.Dr.Rexhep Suma
Asistenti:	/
Të dhënat kontaktuese:	rexhepsuma05@gmail.com
Forma e ofrimit të lëndës :	Lënda mbahet: - më prezencë në klasë për mësimin teorik dhe më pas pjesa praktike të mësimin. - diskutimi i temave dhe konsultave në mënyrë sinkrone.
Motoja e lëndës: “Dituria nuk ka vlerë përveç nëse e fut në praktikë”	

QËLLIMI I LËNDËS		
Kjo lëndë do tu ndihmoj studentëve të ndërtojnë, ngritin dhe testojnë vlerat e tyre në komunikim, si dhe të stimuloj mendimin kritik me qëllim të diskutimit të tema të ndryshme kontroverse në botën e medieeve në raport me shkencat e komunikimit .Ky kurs është një kurs i ri në fushën e komunikimit në media, që do përfshijë një qasje dhe metodologji tipike: funksionaliste e strukturaliste të komunikimit në sidomos periudhe e revolucionit të teknologjisë informative. Moduli, do i adresohet kryesisht termave dhe çështjeve që kanë të bëjnë me bazat e komunikimit në media. Qëllimet e kursit janë që fitohen njohuri dhe dije të reja nga sfera e komunikimit politik ne media, si një teknologji dhe shkencë në vete që përmban koncepte bazë, përkufizime dhe aplikimet kërkimore të teorive të shekullit tonë. Kjo lëndë është një hyrje në shkencën e medieeve dhe komunikimit, si dy pjesë përbërëse dhe të pandashme në botës mediale. Lënda është dizajnuar në atë mënyrë që t’ju pajisë me pjesën teorike dhe analitike të shkencës së medieeve dhe komunikimit si dhe të arriturave shkencore në botën e komunikimit. Përmes kombinimit të ligjëratave dhe detyrave do të kuptoni për zhvillimin e medieeve nëpër etapa të ndryshme kohore dhe mësoni për metodat e komunikimit dhe rëndësinë e tyre në punë e në jetë. Ligjëratat do të fokusohen në shkencat e komunikimit dhe shkencën e medias. Fillimisht do të njohim nocionin komunikim dhe lidhshmërinë e tij me semiologjinë, pastaj me mjetet e komunikimit, rëndësinë e kësaj shkencë në ekzistencën njerëzore. Më pastaj ligjëratat do të ve në pah teoritë e ndryshme të komunikimit dhe rëndësinë e komunikimit masiv. Po ashtu do të thellohem në rëndësinë njohjes së bindjes së masave përmes komunikimit si mjete shumë të rëndësishme në jetë.		
P R O G R A M I	JAVËT	TEMA
	I	- Prezantim i përgjithshëm i përmbajtjen e syllabusit dhe çështjeve që ndërlidhën me përmbajtjes së lëndës
	II	Hyrje në shkencat e komunikimit
	III	Gjuha si mjet i komunikimi masiv dhe simbol në perspektivë krahasuese
	IV	Perspektiva e komunikimit masiv
	V	Mediumi është mesazhi
	VI	Përcaktimi dhe definimi i shtypit islam

	VII	Kollekfiumi I
	VIII	Globalizimi kulturor dhe komunikimi global
	IX	Komunikimi masiv si hapësirë publike
	X	Politika e mediave dhe etika e medieve
	XI	Mediat islame, objektivat dhe specifikat
	XII	Efektet sociale të komunikimit masiv
	XIII	Interneti dhe teknologjitë e reja të informacionit
	XIV	Mediat dhe shoqëria
	XV	Rezyme e lëndës

REZULTATET E TË NXËNIT – NJOHURITË, SHKATHTËSIT DHE KOMPETENCAT

Pas përfundimit të kursit studenti pritët të dijë, kuptoj ose të jetë në gjendje të demonstroj:

Njohuri:

- Të njohin nocionet dhe karakteristikat themelore të bazave të komunikimit dhe hulumtimi në komunikime kundruall formave të zakonshme të shkrimit.
- Të arrijnë të konceptojnë një bazatë komunikimit hulumtimi në komunikime në përputhje me veçantitë e tij strukturore.
- Të zotërojnë teknikën e përdorimit të drejtë të referencave.
- Të shkruajnë ese, punime seminarike dhe të diplomës bazuar në njohuritë e fituara teorike;
- Të jetë në gjendje të analizoj dhe debatojë efektet shumëdimensionale të burimeve të ndryshme të informacionit në mënyrë korrekte.
- Të menaxhoj në mënyrë praktikë më procesin e organizimit të një hulumtimi.
- Të planifikoj dhe programojë punën praktike profesionale

Shkathtësitë/ Aftësitë

- Të aftësohen për të bërë leximin kritik të teksteve universitare,
- Të aftësohen për të vlerësuar një tekst akademik,
- Të zhvillojnë në nivel të kënaqshëm aftësitë shprehëse, teknikat e komunikimit dhe hulumtimi në komunikime,
- Të jenë në gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive duke shprehur idetë sa më efektivisht, duke dëgjuar me kujdes. Do të zhvillohen aftësi në komunikim verbal dhe joverbal, përgatitje dhe prezantim i materialeve mësimore, planeve, dokumenteve të vlerësimit, raporteve.
- Të arrij të dëshmoj dhe respektojnë diversitetin në grupet me të cilat punojnë.
- Ndjenja e përgjegjësisë dhe marrjes së vendime të bazuara mbi drejtësi dhe barazi.

Kompetenca:

- Të dëshmoj aftësi në thellimin e njohurive shkencore dhe profesionale, si një lëmë i domosdoshëm dhe i patjetërsueshëm, për krijim, pavarësim dhe aftësim në kryerjen e punëve të bazave të komunikimit dhe hulumtimi në komunikime.
- Studenti duhet të kryejë punime me nivel të lartë shkencor (ese, detyra kursi, punime të tjera, punime diplome etj.)
- Janë në gjendje të përdorin teknologjinë kompjuterike me qëllim të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për t'i përdorur në procesin e planifikimit dhe përcaktimit të ngarkesave në ligjërata.
- Aftësia e komunikimit të mirë dhe organizimit të punës ekipore duke marrë përgjegjësi për suksesin e vet dhe të grupit.
- Përdorin, në mënyrë strategjike, njohurit nga fusha e pedagogjisë dhe didaktikes dhe janë në gjendje të respektojnë aspektet etike dhe sociale në kuadër të procesit të mësim nxënies.

Ngarkesa e studentit

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/ javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/ punë në laborator/ ushtrime			
Punë praktike	1	15	15
Përgatitje për test intermediar			
Konusltime me mësimdhënësin	0.5	6	3
Puna në terren	2	1	2
Test, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			3
Përgatitje për provim final			4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			3
Projekte, prezantime, etj.			
Total			75

LITERATURA

Literatura themelore:

1. Ligjëratat përgatitura nga profesori i lëndës, Prof. Ass. Dr.Rexhep Suma.
2. Ronald B.Adler, George Rodman, Athena du Pre, Hyrje në komunikim, UETpress,Tiranë, 2023.
3. Rexhep Suma, Islami dhe Identiteti, Logos-A, 2020.
4. Hatice Aydoğan, Amësia digjitale, Logos-A, Shkup, 2023.
- 5.Geraldine Muhlmann, Gazetaria në demokraci, Zenit, Tiranë,2021.
6. Rexhep Suma, Reflektim mendimesh në da've, FSI,2018.
7. Artan Fuga, Komunikimi në shoqërinë masive, Papirus, Tiranë, 2014.
- 8.Aleksandër Dh. Dhima, Antropologjia e Komunikimit, Tiranë, 2013.

Literatura plotësuese:

1. Christian Delporte Caroline Moine, Kulturë media pushtete, Zenit, Tiranë,2019.
- 2.Jan Jagodzinski, Televizioni dhe kultura rinore, Zenit, Tiranë,2018.
3. Artan Fuga, Mediamorfozë dhe metakomunikim, Papirus, Tiranë,2017.
4. Zylyftar Bregu, Teknologjia e lajmit, Pegi, Tiranë,2017.
- 5.Jaup Zenuni, Komunikimi ndërkombëtarë, Extra, Tiranë, 2011.
6. Nick Couldry, Media, Shoqëria, Bota, Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë, 2011.
7. Baylon, Christian & Mignot, Xavier, *Komunikimi. Edicioni i 3-të*. Logos-A, Shkup,2004.
8. Marshall McLuhan, Instrumentat e Komunikimit, media si një zgjatim i njeriut, Tiranë, 2004.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Realizimi i mësimdhënies do të zhvillohet nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve nga lëmi i “Bazat e komunikimit”. Në këtë kontekst, si forma të punës në interpretimin e përmbajtjeve të veprave do të jenë ligjëratat e rregullta, esetë, ushtrimet, diskutimet, puna në grupe dhe, për të gjitha këto, do të përdoren teknika dhe metodat e reja. Natyra e lëndës mundëson shumëllojshmëri qasjesh të mësimdhënies dhe strategjive të mësimdhënies. Nga ju kërkohet reflektim kritik dhe qasje refleksive për të zhvilluar të menduarit kritik. Çdo formë e paraqitur është e hapur për diskutim dhe modifikim përmes dakordimit të përbashkët.

- **Ligjëratat** - Ligjëratat mbahen sipas orarit të publikuar në web faqe, www.fsi-edu.net. Inkurajoheni të jeni sa më aktiv dhe fleksibil si dhe të përfshirë në të gjitha detyrat që realizohen në klasë.
- **Ushtrimet praktike** – Pjesa e praktikës do të jetë demonstrim i njohurive dhe shkathtësive të përfituara në ligjëratë si dhe me hulumtimin që përcaktohet nga profesori dhe studenti paraprakisht në funksion të temës.
- **Punë individuale dhe detyra** - Gjatë realizimit të mësimi do të keni edhe detyra individuale për të përmbushur obligimet. Detyrat mund të përzgjedhë nga:
- Plani i orës i përgatitur për të mbajtur orën praktike.

- Analizë e planit të ndonjërit nga shokët e grupit tuaj.
- Vlerësim i ndonjë pjese të strukturës së orës me analizë të thellë dhe sqarim për çështjet specifike.
- Projekt hulumtimi i propozuar për nxënësit i propozuar sipas formatit të lëndëve për mësim zgjedhorë.
- **Punim seminarik** – Punimi i seminarit duhet të jetë i karakterit hulumtues dhe duhet të përmbajë elementet përbërëse të një hulumtimi. Kjo mund të realizohet në formë si hulumtim rasti, analizë e literaturës specifike, projekt.

FORMAT E VLERËSIMIT

- **Provimi final 30%**– Provimi final mbahet në përfundim të semestrit në bazë të orarit të publikuar në web faqen e Fakultetit . Provimi përbëhet nga 50 pyetje të llojeve të ndryshëm, të cilat mbulojnë të gjitha temat dhe problematikat e diskutuara gjatë tërë semestrit. Pyetje të mbyllura, ta hapura, pyetje me zgjedhje, etj . Rezultatet e provimit do të publikohen në sistemin [SEVS](#)
- **Kolektivum I dhe II (10+10%=20% totali) -** Do të organizohen dy kolekfiume si formë e vlerësimit përmbledhës. Kolekfiumet do të mbahen në javën e 7 dhe në javën e 15. Testi do të përbëhet nga lloje të ndryshëm të pyetjeve të cilat mbulojnë temat dhe problematikat e zhvilluar gjatë javëve paraprake.
- **Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim 10%:** Pjesëmarrja juaj do të regjistrohet në formë elektronike dhe ju do mund të gjeneroni raportin për gjendjen në kohë reale.
- **Punimi seminarik i prezantuar 20 %** – ju mund të zgjedhoni njërin nga mundësit e paraqitur më lartë për ta realizuar në mënyrë të pavarur. Paraprakisht duhet të dakordoheni me profesorin për llojin e seminarit.
- **Nota finale:** Nota finale do të pasqyrojë përmbledhjen e të gjitha rezultateve të grumbulluara nga vlerësimi semestral.

Format e vlerësimit	Përqindja		Përqindja totale	Nota përfundimtare
Provimi final 30%	30%		<50%	Nuk kalon
Kolektivum I	20%		>50%	Kalon
Kolektivum II	20%		51-60%	6
Pjesëmarrja dhe angazhimi	10%		61-70%	7
Punimi seminarik i prezantuar	20%		71-80%	8
			81-90%	9
			91-100%	10

Standardi i notimit në FSI:

0- 49= 5
 50 – 59=6
 60 – 69=7
 70 – 79=8
 80 – 89= 9
 90 - 100=10

POLITIKAT AKADEMIKE

Pjesëmarrja në ligjërata është obligative. Mos përcjellja e ligjëratave për më shumë se 30% të orëve ju pamundëson daljen në provim dhe obligoheni që ta përsërisni kursit në vitin vijues akademik.

Duhet të respektohen afatet kohore për dorëzimin e detyrave të kërkuara

Në realizimin e punëve seminarike dhe projekteve hulumtuese duhet të respektohet kodi i etikës për kërkim shkencorë

Citimi i burimeve duhet të bëhet sipas Udhëzues për Referenca Akademike dhe për Shkrimin e Bibliografisë

Gjatë organizimit të vlerësimeve të ndryshme duhet të respektohen rregullat e mbajtjes së provimeve sipas rregullores së studimeve

Çdo shkelje e cila vlerësohet si e tillë nga ana e profesorit apo me raportim nga ndonjëri studentë do të trajtohet sipas rregullores disiplinore të FSI-së.

Studenti është i obliguar për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve (mbahet evidenca për studentët e rregullt). Të gjithë studentët janë të obliguar t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë gjatë mësimin, ç'kycja e telefonave celular, dhe hyrja me kohë në sallë.